



Fond za humanitarno pravo



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

Prezantimi dhe evaluimi i Bazës së të dhënave të Librit të Kujtimit të Kosovës

4 shkurt 2015, në ora 11.00

Biblioteka Kombëtare, "Pjetër Bogdani" Prishtinë

Amfiteatri i madh

Prezantimi i bazës së të dhënave të Libër Kujtimit të Kosovës, të cilën së bashku e kanë ndërtuar Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë) mbi njerëzit, të cilët e kanë humbur jetën ose janë zhdukur në lidhje me luftën në Kosovë në periudhën prej datës 1 janar të vitit 1998 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000, me rastin e evaluimit të kësaj baze, të cilën e ka bërë ekipi i ekspertëve ndërkombëtar për analiza kuantitative dhe statistikore të humbjeve njerëzore në konfliktet e armatosura.

Folës:

Natasha Kandiç, koordinatore e projektit Libër Kujtimi i Kosovës,

Dr Patrick Ball, ekspert për analizën e shkeljeve të të drejtave të njeriut në konfliktet e armatosura dhe

Profesor Michael Spagat, Royal Holloway, Universiteti i Londrës, ekspert për „matematikën e luftës“

Faktet

Në bazë të **31.600 dokumenteve** është dokumentuar vdekja ose zhdukja në lidhje me luftën e **13.535 njerëzve**, nga data **1 janar e vitit 1998 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000**, dhe atë 10.812 shqiptarë, 2.197 serb dhe 526 romë, boshnjak, malazez dhe joshqiptarë të tjerë. Shikuar sipas statusit të viktimave, jetën e kanë humbur ose janë zhdukur në lidhje me luftën 10.317 civilë, prej të cilëve 8.676 shqiptarë, 1.196 serb dhe 445 romë dhe të tjerë, si dhe 3.218 pjesëtarë të formacioneve të armatosura, prej të cilëve 2.131 pjesëtarë të UÇK-së dhe FARK-ut, 1.084 pjesëtarë të forcave serbe dhe tre pjesëtarë të KFOR-it.

Në bazë të 4.838 dokumenteve¹, midis të cilave 2.136 deklaratave të dëshmitarëve/anëtarëve të familjes, është vërtetuar se në lidhje me luftën **në vitin 1998** jetën e kanë humbur ose janë zhdukur **2.156 njerëz**, prej të cilëve 1.804 shqiptarë, 289 serbë dhe 63 romë dhe të tjerë. Të dhënat tregojnë se në mesin e viktimave civile janë 1.100 shqiptarë, 132 serbë, 46 romë dhe të tjerë, kurse të atyre ushtarake (878), 703 pjesëtarë të UÇK-së dhe 175 pjesëtarë të UJ/MPB të Serbisë.

¹ Pos 2.136 deklaratave, në mesin e dokumenteve janë: 1.156 fotografi të viktimave, 539 artikuj të mediave, fotografi të 361 përmendoreve-shënimeve përkujtimore, 56 dokumente personale, 43 vërtetime, 149 dokumente gjyqësore dhe 398 dokumente të tjera.



Fond za humanitarno pravo



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

Sipas të dhënave nga 22.041 dokumente², në mesin e të cilave 9.592 janë deklarata të dëshmitarëve dhe të anëtarëve të familjes, **10.122** viktime (8.701 shqiptarë, 1.191 serbë dhe 230 romë dhe të tjerë) e kanë humbur jetën ose janë zhdukur në lidhje me luftën në periudhën prej datës **1 janar – 14 qershor 1999**. Viktime civile janë 7.903, prej të cilëve 7.346 shqiptarë, 385 serbë dhe 172 romë dhe të tjerë. Nga gjithsejtë 2.219 viktime ushtarake, janë 1.354 pjesëtarë të UÇK-së dhe 865 pjesëtarë të UJ/MPB të Serbisë.

Të dhënat nga 3.558 dokumente³, në mesin e të cilëve janë 1.472 deklarata të dëshmitarëve ose të anëtarëve të familjes, vërtetojnë se në periudhën prej datës **14 qershor të vitit 1999 deri në datën 31 dhjetor të vitit 2000**, në lidhje me luftën janë vrarë ose janë zhdukur **1.257** njerëz, prej të cilëve 717 serbë, 307 shqiptarë dhe 233 romë, boshnjakë dhe të tjerë.

Në periudhën prej datës **24 mars deri në datën 9 qershor të vitit 1999**, në eksplozimimin e granatave, nga predhat dhe bombat e hedhura nga NATO-ja, janë zhdukur **758 njerëz**: 488 në Kosovë (249 shqiptarë, 202 serbë dhe 37 romë dhe të tjerë), 260 në Serbi dhe 10 në Mal të Zi. Në mesin e viktimave janë 453 civilë, prej të cilëve 220 shqiptarë, 205 serbë, 28 romë dhe të tjerë, si dhe 305 pjesëtarë të formacioneve të armatosure, prej të cilëve 276 pjesëtarë të UJ/MPB të Serbisë dhe 29 pjesëtarë të UÇK-së. Të dhënat bazohen në 1.468 dokumente dhe 539 deklarata të dëshmitarëve dhe të anëtarëve të familjes, të dhëna të FDH dhe FDHK.

Kontakt: Bekim Blakaj

Email: blakaj@hlc-kosovo.org

² Pos 9.592 deklaratave të dëshmitarëve, në mesin e dokumenteve janë: 4.997 fotografi të viktimave, 1.234 artikuj të mediave, 1.647 përmendore-shënime përkujtimore, 1.280 vërtetime, 973 dokumente personale, 513 dokumente gjyqësore dhe 1.795 dokumente të tjera.

³ Pos 1.472 deklaratave, në mesin e dokumenteve janë: 630 fotografi të viktimave, 345 artikuj të mediave, 79 fotografi të përmendoreve-shënimeve përkujtimore, 273 vërtetime, 261 dokumente personale, 118 dokumente gjyqësore dhe 380 dokumente të tjera.